

Breaking News:

Velipojë/Procedohen penalisht 3 shtetas, për veprën penale “Keqtrajtimi i kafshës”





28/08/2026

DVP Elbasan/Kanosë Me Armë Të Dyshuar Manovër, Punonjësit E Policisë Të Angazhuar Për Kapjen E Vëllait Të Tij (Shtetas Në Kërkim), Arrestohet 41-Vjeçari

DVP Elbasan

Kanosë me armë të dyshuar manovër, punonjësit e Policisë të angazhuar për kapjen e vëllait të tij (shtetas në kërkim), arrestohet 41-vjeçari.

Sekuestrohet sendi i ngjashëm me armën e zjarrit.

Specialistët e Hetimit të Krimeve të DVP Elbasan, në bashkëpunim me oficerët e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, arrestuan në flagrancë shtetasin B. B.(Ç.), 41 vjeç, banues në Elbasan.

Ky shtetas, në lagjen “Visarion Xhuvani”, ka kanosur me armë të dyshuar manovër, 4 punonjës të Forcës Operacionale të DVP Elbasan, gjatë kryerjes së kontrolleve dhe veprimeve operacionale të tjera, për kapjen e vëllait të 41-vjeçarit, shtetasit B. B., që është në kërkim për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”.

Ndërkaq, vijojnë intensivisht kontrollet për kapjen e shtetasit B. B..

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme, për shtetasin B. B.(Ç.), për veprat penale “Kanosja për shkak të detyrës” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”.



Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

 GET IT ON
Google Play

 Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent

◀ Policia e Shtetit/Kapet në Durrës, 1 shtetas i akuzuar për disa krime, në Norvegji dhe në Shqipëri

Rezultatet kryesore të strukturave policore në vend dhe ngjarjet e ndodhura gjatë 24 orëve të fundit ▶